



Pranuar / Dorëzuar Punë/Proclato Received/Deliverty	13.02.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org /Unit	Nr Prot (tr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHC	1728/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1318/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1318/2022 të datës 30.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me Nr. Ref.644/2022 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të datës 09.12.2022, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1318/2022 të datës 30.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi përmes përfaqësuesit me autorizim, me datë 30.12.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është regjistruar me numër protokolli 8649/2022, kundër Vendimit Nr.ref.644/2022 të datës 09.12.2022 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale dhe procedurave ligjore, vendim të cilin sipas shkresave të lëndës është konstatuar se i njëjti e ka pranuar me datë 12.09.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në MPJD. Këshilli, me datë 20.01.2023 me numër protokolli: 589/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 30.12.2022, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me nr.ref.644/2022 të datës 09.12.2022; Autorizimin e datës 19.12.2022; Konkurs për anëtarët e personelit diplomatik i datës 22.07.2011; Formulari i Vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm i datës 27.10.2020; Formulari i Vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm i datës 27.10.2021; Kopja e letërnjoftimit; E-mail i ankuesit dërguar Sh.M i datës 22.07.2020; E-mail i dërguar nga Ministria e Punëve të jashtme drejtuar A.M e datës 09.12.2022; E-mail i dërguar nga ankuesi drejtuar F.A i datës 21.03.2022; Vendim i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me nr.ref.477/2020 i datës 29.07.2020; Vendim me nr. 338/2019 i datës 15.07.2019; Vendim për sistemimin e përkohshëm me nr. 108/2019 i datës 09.09.2019; Vendim me nr.ref.192/2014 i datës 08.04.2014; Vendim për lëvizje paralele dhe transfer me nr.ref. 445/2014 i datës 24.06.2014; Vendim me nr.585/2018 i datës 13.07.2018; Vendim për shpallje të konkursit me nr.151/2011 i datës 21.07.2011; Konkurs për drejtues dhe nëpunës tjerë konsullor me nr.prot.5514 i datës 28.12.2022; E-mail i dërguar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës drejtuar përfaqësuesit të ankuesit i datës 28.12.2022; Aktvendim i Gjykatës së Apelit AN.nr.47/2022 i datës 20.10.2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 11.01.2023; Përgjigja në ankesë e datës 20.01.2023; Vendim për emërim dhe caktim të gradës diplomatike me nr.ref.620/13 i datës 24.01.2013; Vendim për lëvizje paralele dhe transfer me nr.ref.176/2014 i datës 21.05.2014; Vendim me nr.ref.762/2016 i datës 15.12.2016; Shkresa e titulluar Vendim (data e palexueshme); Pliko e bardhë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të shkresave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1318/2022 të datës 30.12.2022 të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga analizimi i provave materiale Kolegji ka gjetur së Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme me Vendimin Nr.151/11 të datës 21.07.2011 ka miratuar shpalljen e Konkursit për përfaqësues diplomatik dhe konsullor në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë vendim, Ministria e Punëve të Jashtme më datë 22.07.2011 shpall Konkursin për drejtues dhe nëpunës të tjerë të misionit konsullor dhe për anëtarë të misionit diplomatik, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi. Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton së lidhur me këtë procedurë konkurrimi ishte organizuar vetëm testimi i gjuhëve të huaja dhe intervista me gojë, dhe nga kjo fazë nuk ka dëshmi për vazhdimin e mëtejshëm të procesit të rekrutimit në fjalë, gjegjësisht pranimit të ankueses në pajtim me dispozitat e aplikueshme për shërbimin e jashtëm dhe shërbim civil.

Rrjedhimisht nga shqyrtimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar së ankuesi bazuar në Vendimin Nr.Ref.192/14 të datës 08.04.2014 të Ministrit të Punëve të Jashtme emërohet anëtar i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës duke i'u caktuar grada diplomatike "Konsull", dhe njëkohësisht i njëjti caktohet të shërbej Konsullatën e Republikës së Kosovës në Romë/Republika e Italisë duke filluar nga data 01.05.2014. Tutje, bazuar në provat e lëndës rezulton së ankuesit me Vendimin Nr.Ref:445/2014 të datës 24.06.2014 të Ministrit të MPJ-së i në kuadër të lëvizjes paralele me gradën e njëjtë caktohet të transferohet në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Milano/Republika e Italisë duke filluar nga data 01.07.2014, dhe po ashtu me Vendimin Nr.Ref:585/2018 të datës 13.07.2018 të Ministrit të MPJ-së, ankuesit i vazhdohet mandati në shërbimin diplomatik në të njëjtin vend deri me datë 01.05.2022. Tutje, ankuesit me Vendimin Nr.Ref:338/2019 të datës 15.07.2019 Ministri i MPJD-së nxjerrë Vendimin përmes të cilit ankuesin e tërheq nga shërbimi diplomatik në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Milano/Republika e Italisë, duke e sistemuar në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme, ndërsa me datën 09.09.2019 Sekretari i Përgjithshëm i MPJ-së përmes Vendimit me nr.108/2019 ankuesin e sistemon përkohësisht në pozitën "Zyrtar i Lartë për Promovim dhe Investime" në Departamentin për Diplomaci Ekonomike, po ashtu përmes e-mailit të datës 22.07.2020 ankuesin e cakton përgjegjës për mbarëvajtjen e punës në Departamentin për Diplomaci Ekonomike. Tutje, Ministri i MPJD-së nxjerrë Vendimin Nr.477/2020 të datës 29.07.2020 përmes të cilit ankuesit me gradën "Konsull" i caktohet të shërbejë në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Hamburg, Republika Federale e Gjermanisë me mandat katër (4) vjeçar duke filluar nga data 15.09.2020, ndërsa përmes e-mailit të datës 21.03.2022 Ambasadori i Republikës së Kosovës në Berlin/Gjermani, ankuesin e ngarkon me punën e "Drejtuesit të Konsullatës" së Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Hamburg/ Republika Federale e Gjermanisë.

Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me Vendimin Nr.ref: 644/2022 të datës 06.12.2022 ka shfuqizuar Vendimin më numën reference 192/2014 të datës 08.04.2014 lidhur me emërimin e ankuesit në Shërbim e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe caktimin e gradës diplomatike "Konsull" si dhe Vendimin nr.ref.477/2020 i datës 29.07.2020 në lidhje me caktimin e ankuesit për shërbim në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Hamburg/Republika Federale e Gjermanisë, mbi bazën ligjore së emërimi i ankuesit në shërbime të jashtëm është bërë në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm, si dhe në kundërshtim me nenin 19 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon së vendimi i kundërshtuar më ankesë karakterizohet me shkelje të dispozitave ligjore, shkelje formale-procedurale, dhe shkeljeve të ligjit material, konkretisht Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm dhe Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi si dhe akteve të tjera nënligjore që janë derivat i ligjeve të lartcekura.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës i aplikueshëm në kohën e emërimit të ankuesit në shërbim të jashtëm, përkatësisht nenit 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik me të cilin parashihet: Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjor, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se përveç të emëruarave politikë, nëpunësit e shërbimit të jashtëm përfshirë personelin diplomatik, konsullor dhe personelin administrativ të punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme apo të angazhuar në shërbim të jashtëm, kanë statusin e nëpunësit civilë dhe së pranimit i tyre në shërbim të jashtëm duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbim të jashtëm dhe legjislacionit të aplikueshëm për shërbim civil, andaj mbi këtë bazë ligjore, si dhe duke marrë parasysh faktin se ankuesi ishte emëruar në shërbim të jashtëm mbi bazën e vendimit të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e meqenëse me asnjë provë nuk vërtetohet se asaj kohe i njëjti ka themeluar marrëdhënie të punës në shërbim civil përmes nënshkrimit të Aktit të emërimit ashtu siç përcaktohej me nenin 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin parashihej se: *Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil....*, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit si në dispozitiv të këtij vendimi.*

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të provave të lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër: A.nr.1318/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së